



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.3/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanicë, kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunitat: Lipjan, Vushtrri dhe Gjilan, në seancën e panelit të mbajtur me 21.05.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Hudhet** si i pasafatshëm apeli i subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), me seli në Graçanicë, i parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunitat: Lipjan, Vushtrri dhe Gjilan.

#### A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit nga subjekti politik PDS me seli në Graçanicë me datën 19.05.2017, ka paraqitur apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së të datës 17.05.2017, në të cilin pretendon se KQZ –ja, me vendimin kontestues ka shkelur nenin 67 të LZP-së, kur ka refuzuar akreditimin e kandidatëve të subjektit PDS për anëtar të Komisionit Komunal Zgjedhor në Komunitat Lipjan, Vushtrri dhe Gjilan. Me propozim për panelin, që ta aprovon apelin dhe ta urdhëron KQZ-në që të rishqyrtoj vendimin e kontestuar dhe që të merren të gjitha masat për eliminimin e pasojave të dëmshme të një vendimi të tillë.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datën 19.05.2017, e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar nga ky komision që deri më datë 20.05.2017 në orën 12:00 të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) , kërkesat për nominime për anëtar të KKZ-ve nga të gjitha subjektet politike parlamentare janë pranuar dhe vendosur në afatin e paraparë me planin operacional të KQZ-së, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017 dhe me datë 17.05.2017, ka shqyrtuar dhe miratuar nominimet për anëtar të KKZ-së. Mëtej në përgjigje theksohet se apeli i subjektit politik PDS, është i pas afatshëm për arsye se vendimi i KQZ-së është publikuar në ueb-faqe të KQZ-së më datën 17.05.2017, në ora 13:02, ndërsa pala ankuese ka parashtruar apel më datën 19.05.2017, në ora 14:00, që rezulton të jetë sipas KQZ-së, jashtë afatit

ligjor, sepse palët në këtë fazë të procesit zgjedhor njoftohen nga KQZ-ja, vetëm përmes publikimit të vendimit në ueb -faqen zyrtare të KQZ-së.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës, në kuptim të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli i ka vlerësuar apelin e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015, Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ngase pala parashtruese e apelit ka të drejtën e parashtrimit të apelit, dhe se PZAP-i ka kompetencën e shqyrtimit të apeleve të kësaj natyre dhe të nxjerrë vendime për apelimet e tilla.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga subjekti politik PDS kundër vendimit të ankimuar të KQZ-së, është i pasafatshëm. Ngase prej shkresave të lëndës del se vendimi i ankimuar i KQZ-së lidhur me nominimet e anëtarëve të KKZ-ve, është marrë nga KQZ-ja më datë 17.05.2017 dhe është publikuar në ueb-faqe të KQZ-së, në të njëjtën ditë në ora 13:02, ndërsa apeluesi ka parashtruar apel në PZAP, më datë 19.05.2017 në ora 14:00. Nga kjo rezulton se apeli është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 122 par. 1 të LZP-së, në të cilat dispozitë ligjore, përcaktohet afati ligjore për të parashtruar apel ndaj vendimeve të KQZ-së, brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallët nga KQZ-ja, ndërsa në rastin konkret parashtruesi i apelit ka parashtrua apel ndaj vendimit të ankimuar të KQZ-së, pas afatit të përcaktuar ligjor sipas dispozitës të lart theksuar ligjore, respektivisht ka parashtruar apel në PZAP, pas 49 orëve që KQZ-ja e ka shpallur-publikuar vendimin.

Prandaj, për arsyet e theksuara më lart, Paneli fare nuk është lëshuar në vlerësimin e pretendimeve në apel dhe në mbështetje të dispozitës të nenit 118 par.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
A nr. 3/2017 më datën 21.05.2017



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*